

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 264/2011
Prishtinë
14 shkurt 2012

Gjyqtari i EULEX-it në Gjykatën Supreme të Kosovës, Gerrit-Marc Sprenger në cilësinë e Kryetarit të kolegjit në ankesën në lëndën penale me numër AP-KZ Nr. 264/2011 kundër të pandehurve:

- 1) [REDACTED], me nofkën [REDACTED] emri i babait [REDACTED], mbiemri i vajzërisë së nënës [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në [REDACTED], shqiptar i Kosovës, me vendbanimin e fundit në fshatin [REDACTED] i pamartuar, ish [REDACTED];
- 2) [REDACTED], i lindur më [REDACTED] në [REDACTED], shqiptar kosovar me vendbanimin e fundit në liri në [REDACTED] fshatin [REDACTED], i martuar, baba i tre fëmijëve, ish [REDACTED];
- 3) [REDACTED], emri i babait [REDACTED], mbiemri i vajzërisë së nënës [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në [REDACTED] shqiptar i Kosovës, me vendbanim të fundit në [REDACTED] i martuar, baba i tre fëmijëve, ish pjesëtar i [REDACTED] së, i papunë; dhe
- 4) [REDACTED], emri i babait [REDACTED], mbiemri i vajzërisë së nënës [REDACTED], i lindur më [REDACTED] në [REDACTED], shqiptar i Kosovës, me vendbanim në [REDACTED] shqiptar kosovar, i martuar, baba i tre fëmijëve, ish pjesëtar i [REDACTED], i papunë;

Duke vepruar sipas detyrës zyrtare në bazë të Nenit 397, par. (1) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

Aktgjykimi Ap.-Kz. nr. 264/2011 i Gjykatës Supreme i datës 12 tetor 2011 korrigjohet si në vazhdim:

- 1) Duke iu referuar paragrafit I) në faqen 2 të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën P. nr. 459/2009 “të datës 7 shkurt 2007” duhet të korrigjohet në “të datës 7 shkurt 2011”.

- 2) Duke iu referuar faqes 4 në lëndën “P. Nr. 628/2004 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 8 maj 2007” duhet të korrigohet në “P. Nr. 459/2009 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 7 shkurt 2011”.

Arsyetim

Aktgjykimi në lëndën në fjalë është shpallur më 12 tetor 2011 ndërsa aktgjykimi me shkrim është dorëzuar për palët në mes të datave 24 – 29 nëntor 2011. Dy palët kanë ushtruar ankesë me kohë kundër këtij aktgjykimi.

Ky aktvendim thjesht i përmirëson këto gabime drejtshkrimore në aktgjykimin me shkrim në bazë të paragrafit (1) të Nenit 397 të KPPK-së, duke mos ndërhyrë në asnjë shënim tjetër të përcaktuar sipas Nenit 391, par. (1), nënpar. (1) deri në (4) si dhe nënpar. (6) i KPPK-së. Për këtë arsye, ky aktvendim nuk ka asnjë ndikim në periudhën kohore për paraqitjen e ankesës Ap. Kz. Nr. 264 / 2011, të datës 12 tetor 2011.

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. nr. 264/2011
14 shkurt 2012
Prishtinë

Kryetari i kolegjit:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtësja:

Tara Khan
Zyrtare ligjore e EULEX-it

Këshillë juridike

Sipas Nenit 397, par. (2) i KPPK-së, nuk lejohet ankesa ndaj këtij Aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 264/2011
Prishtinë
12 tetor 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën sipas nenit 26 paragrafit (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK-së) më 11 tetor 2011, në ndërtesën e Gjykatës Supreme, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve të EULEX-it Martti Harsia dhe Charles Smith III dhe gjyqtarëve të Gjykatës Supreme Marije Ademi dhe Salih Toplica, si anëtarë të kolegjit.

Dhe me procesmbajtësen Svetoslava Savova,

Në prani të

Prokurorit Publik Juzuf Mezini, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK)

Avokatëve mbrojtës [redacted] dhe [redacted] për të pandehurin [redacted]
[redacted] dhe [redacted] për të pandehurin [redacted] [redacted] për të
pandehurin [redacted] dhe [redacted] për të pandehurin [redacted]

Palëve të dëmtuara [redacted] [redacted] [redacted] [redacted]
[redacted], [redacted], të përfaqësuar nga [redacted]

Në lëndën penale me numër AP-KZ Nr. 264/2011 kundër të pandehurve:

- 1) [redacted], me nofkën [redacted] i lindur më [redacted] në [redacted] shqiptar i Kosovës, vendbanimi i fundit në liri në fshatin [redacted], emri i babait [redacted], mbiemri i vajzërisë së nënës [redacted] [redacted], i pamartuar, ka mbaruar shkollën e mesme, ish [redacted] me gjendje ekonomike mesatare, vazhdimisht në paraburgim prej 21 janarit 2008 në lidhje me një tjetër procedurë penale në Burgun e Dubravës;
- 2) [redacted] i lindur më [redacted] në [redacted], shqiptar i Kosovës, vendbanimi i fundit në liri [redacted], fshati [redacted], emri i babait [redacted], mbiemri i vajzërisë së nënës [redacted] [redacted] i martuar, baba i tre fëmijëve, shkollën e mesme (të papërfunduar), ish [redacted], me gjendje të mesme ekonomike, vazhdimisht në paraburgim prej 21 janarit 2008 në lidhje me një tjetër procedurë penale; aktualisht në paraburgim në Burgun e Dubravës.
- 3) [redacted] i lindur më [redacted] në [redacted] shqiptar i Kosovës, me vendbanim në [redacted] Komuna e Kaçanikut, emir i babait [redacted] mbiemri i

vajzërisë së nënës [REDACTED] [REDACTED] i martuar, baba i tre fëmijëve, ka mbaruar shkollën fillore, me gjendje të mesme ekonomike, i papunë;

- 4) [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në [REDACTED] shqiptar i Kosovës, me vendbanim në [REDACTED] emri i babait [REDACTED] mbiemri i vajzërisë së nënës [REDACTED] i martuar, baba i tre fëmijëve, ka mbaruar shkollën e mesme, ish pjesëtar i [REDACTED] së; i papunë; me gjendje ekonomike mesatare.

I. Me aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në lëndën P.nr. 459/2009, të datës 7 shkurt 2007, të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në të njëjtën ditë, të pandehurit janë shpallur fajtorë për veprat penale në vijim:

1. [REDACTED] së bashku me të bashkëpandehurin [REDACTED] për shkak se:

a. në mes të orës 00.10-00.15 të natës në mes të 27 dhe 28 shtatorit 2007 ata kanë vrarë [REDACTED] dhe [REDACTED] në mënyrë dinake të [REDACTED] e [REDACTED] (e cila gjendet në rrugën nga [REDACTED] e cila shpie në fshatin [REDACTED]). Në veçanti, të pandehurit ia kanë zënë pritën veturës Golf 2 me targa [REDACTED], në të cilën [REDACTED] dhe [REDACTED] (së bashku me [REDACTED] dhe [REDACTED]) ishin duke udhëtuar në drejtim të fshatit [REDACTED]. Kur vetura ka arritur te [REDACTED] dhe [REDACTED] i (të cilët ishin duke pritur në anën e djathtë të rrugës) kanë hapur zjarr mbi veturën me dy pushkë automatike AK 47. [REDACTED] është qëlluar me shumë plumba në pjesën e djathtë të trupit dhe një plumb e ka qëlluar në pjesën e djathtë të kokës, duke hyrë në tru dhe duke ia shkaktuar vdekjen. [REDACTED] ka vdekur si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga plumbat në zemër, mushkëri dhe mëlçi, dhe [REDACTED] ka vdekur si pasojë e lëndimeve të shkaktuara nga plumbat në pjesën e djathtë të kokës.

Prandaj, [REDACTED] dhe [REDACTED] së bashku kanë kryer veprën penale Vrasje e rëndë, në kundërshtim të neneve 23, 147, paragrafi 1, nn. 3 dhe 11, të KPK-së.

b. mes të orës 00.10-00.15 të natës në mes të 27 dhe 28 shtatorit 2007 ata kanë tentuar të vrasin [REDACTED] dhe [REDACTED] në mënyrë dinake të [REDACTED] e [REDACTED] (e cila gjendet në rrugën nga [REDACTED] e cila shpie në fshatin [REDACTED]). Në veçanti, të pandehurit ia kanë zënë pritën veturës Golf 2 me targa [REDACTED], në të cilën [REDACTED] dhe [REDACTED] ishin duke udhëtuar në drejtim të fshatit [REDACTED]. Kur vetura ka arritur te [REDACTED] dhe [REDACTED] i (të cilët ishin duke pritur në anën e djathtë të rrugës) kanë hapur zjarr mbi veturën me dy pushkë automatike AK 47. Së paku 40 plumba nga AK 47 kalibri 7.62 janë shtënë në veturën e përdorur nga viktimat. [REDACTED] është qëlluar nga plumbat në kokë dhe në anën e djathtë të abdomenit, përfshirë indet lëkurore, indet e qelizave, ascenden të zorrës së trashë, i cili tani ka depërtuar dhe përbërja e të cilit është shpërndarë abdomen dhe në veçanti ka dëmtuar omentum majus. Përkundër lëndimeve të rënda, [REDACTED] ka mbijetuar.

[REDACTED] drejtpërdrejtë ka qenë i ekspozuar ndaj rafalit të plumbave të cilët kanë shkaktuar vdekjen dhe lëndimet e viktimave të tjera, mirëpo për mrekulli ka mbetur i palënduar.

Duke vepruar në këtë mënyrë [REDACTED] dhe [REDACTED] qëllimisht kanë ndërmarrë veprime të menjëhershme në drejtim të kryerjes së veprës penale Vrasje të rëndë në tentativë, kështu bashkërisht kanë kryer veprën penale të përshkruar në nenet 20, 23, 147, paragrafin 1, nn. 3 dhe 11 të KPK-së;

c. në rrethanat e përshkruara më lart nën pikat 1 dhe 2, ata pa autorizim kanë transportuar, kanë pasur në posedim dhe kanë përdorur dy pushkë automatike të modelit Kallashnikov AK 47 të kalibrit 7.62, me të cilat kanë kryer veprat penale të përshkruara më lart nën pikat a. dhe b.

Prandaj, [REDACTED] dhe [REDACTED] së bashku kanë kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

2. [REDACTED] për shkak se në një datë të paspecifikuar në muajin shtator 2007 ka pranuar nga [REDACTED] një pushkë automatike Kallashnikov AK 47 të kalibrit 7.62. [REDACTED] ka testuar pushkën automatike në malet e [REDACTED]. Pas vrasjes së [REDACTED] ai ka kërkuar dhe ka marrë nga [REDACTED] vëllai i [REDACTED] kthimin e pushkës në fjalë AK 47, së bashku me një pushkë tjetër AK 47, të cilat vetë ai i ka marrë me vete.

Prandaj, ai ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

3. [REDACTED] është liruar sepse nuk është provuar se ai ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

II. Prandaj, të pandehurit janë dënuar si në vijim:

1. [REDACTED] dhe [REDACTED] janë dënuar

a. me dënim afatgjatë me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetetë (33) viteve për veprën penale të përshkruar në pikën a;

b. me dënim prej dhjetë (10) viteve burgim për veprën penale të përshkruar në pikën b;

c. me dënim prej dy (2) viteve burgim për veprën penale të përshkruar në pikën c;

Sipas nenit 71, paragrafit 2, n.1, të KPK-së, dënimi unik prej 33 viteve burgim afatgjatë i është shqiptuar të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED]

2. [REDACTED] është dënuar me dënim me gjobë prej 5,000 Euro në lidhje me veprën penale të përshkruar në pikën d, e cila duhet të paguhet nga i pandehuri brenda tre (3) muajve pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Në rast se gjoba nuk mund të paguhet me detyrim ajo do të zëvendësohet me një ditë burgim për çdo pesëmbëdhjetë Euro të gjobës.

Sipas nenit 112, paragrafit 2 dhe nenit 392 të KPPK-së, [REDACTED] dhe [REDACTED] në mënyrë kumulative dhe të përbashkët, janë dënuar me pagesën e shumë prej 25,000 Euro për secilin prej palëve të dëmtuara [REDACTED], [REDACTED] [REDACTED], si kompensim i pjesshëm për dëmin e vuajtur moral.

Avokatët mbrojtës e të akuzuarit [REDACTED] Av. [REDACTED] dhe Av. [REDACTED] secili prej tyre kanë paraqitur ankesa me kohë kundër aktgjyqimit, Av. [REDACTED] me datën 25 maj 2011 dhe Av. [REDACTED] me datën 11 qershor 2011. Të dy avokatët mbrojtës pohojnë se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të kodit penal, dhe Av. [REDACTED] përveç kësaj, gjithashtu kundërshton edhe vendimin mbi dënimin. Është propozuar aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit [REDACTED] Av. [REDACTED] me kohë ka paraqitur ankesë kundër aktgjyqimit të shkallës së parë i cili është regjistruar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 3 qershor 2011, duke pohuar se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 të KPPK-së, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së dhe shkelje të kodit penale sipas nenit 404 të KPPK-së.

I pandehuri [REDACTED] me ankesën e tij me shkrim të datës 30 maj 2011, gjithashtu ka paraqitur ankesë me kohë kundër aktgjyqimit të shkallës së parë dhe pohon se aktgjykimi përmban vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe se vendimi mbi dënimin është i padrejtë. Prandaj, ai propozon që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe që Gjykata ta shpallë të pandehurit të pafajshëm.

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK-së) përmes ankesës së tyre të paraqitur me kohë më 26 maj 2011 ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë për shkelje substanciale të kodit të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, dhe për këtë arsye propozon që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj ankesën e ZPSHK-së kështu që aktgjykimi P.nr. 459/2009 i datës 7 shkurt 2011 në lidhje me të pandehurit [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] dhe [REDACTED] të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

PSRK me anë të mendimit me shkrim të datës 04 gusht 2011 të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës në të njëjtën ditë mbështet ankesën e PSRK-së në lidhje me shkeljet e pretenduara të procedurës penale dhe prandaj propozon që aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Në bazë të aktgjyqimit me shkrim në lëndën P. Nr. 628/2004 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 08 maj 2007 (e regjistruar në shkrimoren e asaj gjykate në të njëjtën ditë), ankesat e dorëzuara me shkrim të të pandehurve dhe avokatëve të tyre përkatës si dhe të PSRK-së dhe ZPSHK-së, dokumentacioni relevant dhe parashtrirat verbale të palëve gjatë seancës më 11 dhe 12 tetor 2011, së bashku me një analizë të ligjit të aplikueshëm, Gjykata Supreme e Kosovës pas këshillimit dhe votimit më 12 tetor 2011, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Ankesat e avokatëve mbrojtës [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të paraqitura në emër të pandehurit [REDAKTUAR] të avokatit mbrojtës [REDAKTUAR] të paraqitur në emër të pandehurit [REDAKTUAR] të pandehurit [REDAKTUAR] dhe të Prokurorit Special [REDAKTUAR] kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 459/2009, të datës 7 shkurt 2011, REFUZOHEN SI TË PABAZUARA. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, VËRTETOHET.

ARSYETIM

Historia e Procedurës

1. Më 28 shtator 2007, në mes të orës 00:10-00:15 të natës, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ishin duke udhëtuar në drejtim të fshatit [REDAKTUAR] me veturën Golf 2 me targa [REDAKTUAR]. Kur kanë arritur te [REDAKTUAR] (e cila gjendet në rrugën nga [REDAKTUAR] cila shpie në fshatin [REDAKTUAR], ndaj veturës së tyre është hapur zjarr nga dy pushkë automatike Kallashnikov AK 47 të kalibrit 7.62 mm, nga ana e djathtë e rrugës. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] janë qëlluar me shumë plumba në pjesën e djathtë të trupit të tyre dhe kanë vdekur si pasojë e lëndimeve, gjersa [REDAKTUAR] është lënduar rëndë mirëpo i ka mbijetuar sulmit dhe [REDAKTUAR] për mrekulli ka mbetur i palënduar.

2. Më 2 nëntor 2009, Prokurori Special i Kosovës ka paraqitur aktakuzën (PPS 41/09) pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë kundër të pandehurve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], duke i akuzuar të pandehurit për Vrasje të rëndë, Vrasje të rëndë në tentativë ([REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]), Bashkim kriminal ([REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]) dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve ([REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]).

3. Pas seancës për konfirmim të mbajtur më 21 dhjetor 2009 dhe 5 janar 2010, vetëm akuzat për Vrasje të rëndë të [REDAKTUAR] në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 1 nënparagrafëve 3, 8 dhe 9; nenit 23 të KPK-së, Vrasje e rëndë e [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 1, nënparagrafit 3 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së dhe Vrasje e rëndë në tentativë të [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kundër të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së kundër të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si dhe për akuzën Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së kundër të pandehurit [REDAKTUAR] janë konfirmuar.

4. Shqyrtimi gjyqësor publik është mbajtur me 19 seanca më 16, 17, 18, 23, 24 qershor, 13, 14, 15 korrik, 06, 14, 16, 29, 30 shtator, 21 tetor, 05, 09 nëntor dhe 09 dhjetor 2010

si dhe më 31 janar dhe 01 shkurt 2011, në prani të Prokurorit të PSRK-së Z. Reshat Millakut, të gjithë të akuzuarve dhe avokatëve të tyre përkatës.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë ka marrë në pyetje dëshmitarët në vijim: [redacted] (16 qershor 2010), [redacted] (17 qershor 2010), [redacted] (18 qershor 2010), [redacted] (23 qershor 2010), [redacted] (24 qershor 2010), [redacted] (13 korrik 2010), [redacted] (13 dhe 14 korrik 2010), [redacted] (14 korrik 2010), [redacted] (15 korrik 2010), [redacted] (06 shtator 2010), [redacted] (14 shtator 2010), [redacted] (16 shtator 2010), [redacted] (29 shtator 2010), [redacted] (30 shtator 2010) dhe [redacted] (21 tetor 2010). Pas prezantimit të provave materiale, të pandehurit janë ekzaminuar nga Gjykata .

5. Këshillimi dhe votimi është mbajtur më 04 dhe 07 shkurt 2011, dhe aktgjykimi është shpallur më 07 shkurt 2011.

6. Më 25 maj 2011 Avokati mbrojtës i të akuzuarit [redacted] Avokati [redacted] dhe më 13 qershor 2011 Avokati mbrojtës i të akuzuarit [redacted] Avokati [redacted] brenda afatit kanë paraqitur ankesë ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë, duke konstatuar shkelje të ligjit dhe duke propozuar që Gjykata Supreme të vendosë siç është përmendur më sipër.

7. Më 3 qershor 2011, mbrojtësi i të akuzuarit [redacted] avokati [redacted] brenda afatit ka paraqitur ankesën personalisht në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, e cila edhe pse në tri kopje kurrë nuk i është bashkëngjitur shkresave të lëndës, por me kërkesën e Kryetarit të kolegjit në Gjykatën Supreme e njëjta kërkesë është dorëzuar edhe një herë pranë kolegjit nga ana e Avokatit mbrojtës.

8. Më 30 maj 2011 i akuzuari [redacted] ka paraqitur ankesë ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë, duke konstatuar shkeljet e ligjit dhe duke propozuar vendim të ri të gjykatës, siç është përshkruar më lart.

9. Më 26 maj 2011, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka kundërshtuar Aktgjykimin e shkallës së parë dhe ka propozuar një vendim të ri të Gjykatës, të theksuar më lart.

10. ZPShK, në mendimin e tyre të dhënë më datën 4 gusht 2011 mbështet ankesën e PSRK-së sa i përket shkeljeve esenciale të procedurës penale dhe duke propozuar edhe ajo si u tha më lart.

Gjetjet e Gjykatës

A. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale

11. Avokatët mbrojtës [redacted] dhe [redacted] për të pandehurin [redacted] shtu sikur edhe Avokati mbrojtës [redacted] për të pandehurin [redacted] dhe PSRK-ja i mbështetur nga ZPShK-ja, kanë kundërshtuar Aktgjykimin e

shkallës së parë për shkak të disa shkeljeve të procedurës penale. Në veçanti, dispozitivit të Aktgjykimit të shkallës së parë i mungojnë elementet e mjaftueshme lidhur me motivin për kryerjen e krimeve si dhe elementet objektive dhe subjektive të dashjes siç përcaktohet me Nenin 174 të KPK-së për shqyrtimin e krimeve të kryera në mënyrë tinëzare. Dispozitivi nuk i referohet ndonjë fakti të rëndësishëm, përderisa arsyet e dhëna më vonë në Aktgjykim janë të paqarta dhe pjesërisht në kundërshti me përmbajtjen e dëshmimeve të dhëna gjatë procedurave të provave. Në veçanti, pika a. dhe b. e dispozitivit të Aktgjykimit të kundërshtuar është kundërthënëse dhe e paqartë, ngase fakti që pika b i referohet një numri prej më se 40 plumbave të shkrepur, përderisa asgjë nuk thuhet lidhur me këtë në pikën a, vë në dyshim faktin nëse të dyja këto pika bëjnë fjalë për të njëjtën situatë apo jo. Për këtë arsye, dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm, kundërthënës me përmbajtjen e vet dhe me arsyet e Aktgjykimit duke shkelur kështu Nenin 403, par. 1, pikën 12 të KPPK-së. Përveç kësaj, sipas Avokatit mbrojtës të të pandehurit [redacted] avokatit [redacted] Aktgjykimi i shkallës së parë shkel Nenin 403, par. 1, pikën 8 të KPPK-së, pasi që mbështetet në prova të papranueshme. Në veçanti, dëshmitë e dëshmitarit [redacted] të dhëna para Prokurorit më 4 mars 2009 dhe para policisë më 2 shkurt 2008 janë të papranueshme, në kuptim të Nenit 156 dhe 157 të KPPK-së, sepse as i akuzuari [redacted] as mbrojtësi i tij nuk kanë qenë të pranishëm në kohën kur janë dhënë këto dëshmi. PSRK-ja, e mbështetur nga ZPSHK-ja, përveç kësaj, ka kundërshtuar Aktgjykimin për shkak se shfajësimi i të akuzuarit [redacted] siç përcaktohet me dispozitivin nuk mbështetet me arsye të mjaftueshme, pasi që Gjykata nuk i ka besuar deklaratës së dëshmitarit [redacted] të dhënë para Prokurorit më 4 mars 2009.

I. MUNGESA E POHUAR E ELEMENTEVE TË DISPOZITIVIT

12. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se dobësitë e pohuara të dispozitivit të aktgjykimit të kundërshtuar nuk arrijnë në atë shkallë serioze sa të justifikojnë anulimin e Aktgjykimit për shkak të shkeljes esenciale të procedurës penale, siç përcaktohet me Nenin 403, par. 1, pikën 12 të KPPK-së.

13. Neni 396, paragrafët 3 dhe 4 të KPPK-së parashohin si domosdoshmëri që dispozitivi duhet t'i plotësojë këto kushte:

(3) Dispozitivi i aktgjykimit duhet të përmbajë të dhënat personale të të akuzuarit (Neni 233, par. 1 i këtij Kodi) dhe vendimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor për veprën për të cilën akuzohet ose për të cilën ai ose ajo është liruar nga akuza ose me të cilin lirohet nga akuza për atë vepër apo me të cilin refuzohet aktakuza.

(4) Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 391 të këtij Kodi, ndërsa kur ai është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin përshkrimin e veprës për të cilën është akuzuar dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale me kërkesën pasurore juridike nëse një kërkesë e tillë është paraqitur.

Neni 391 i KPPK-së, në kuptim të Nenit 396, par. 4 të KPPK-së parasheh në paragrafin 1, që lidhet me rastin në fjalë, si në vazhdim:

(1) Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon:

1) Për cilën veprë shpallet fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;

2) Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit;

3) Dënimin e shqiptuar të akuzuarit...

1. Kushtëzimi i përmendjes së motiveve në dispozitiv

14. Në veçanti, ligji në përgjithësi nuk kushtëzon kurrfarë përmendje në dispozitiv të motiveve për kryerjen e krimit. Edhe pse Neni 391, par. 1 pika 1 e KPPK-së kushtëzon "...përmendjen e fakteve dhe të rrethanave të cilat tregojnë natyrën penale të veprës së kryer...", kjo rregull nuk i referohet motivit për kryerjen e një krimi, pasi që motivi sipas përkufizimit *per definitionem* nuk është pjesë themelore kushteve objektive apo subjektive të veprës penale. Të gjitha veprat penale përbëhen nga kriteret objektive të cilat përshkruajnë elementet e një krimi të caktuar si dhe nga kriteret subjektive, të cilat përshkruajnë gjendjen shpirtërore të kryerësit siç është shkalla e caktuar e vullnetit apo gatishmërisë apo e pakujdesisë. Për dallim nga kjo, motivet e një krimi mund të mbeten të panjohura dhe si të tilla nuk janë fare të nevojshme në kontekstin e vlerësimit të fajit përkitazi me kryerjen e krimit. Megjithatë, posa të zbulohen, motivet mund të përforcojnë edhe më tepër përgjegjësinë penale të kryerësit të caktuar.

15. Në këtë kontekst, sa i përket Vrasjes së rëndë, sipas Nenit 147 të KPK-së, ligji vërtet njeh disa konstalacione të cilat u referohen motiveve në një masë të caktuar. Kjo gjë për shembull mund të konsiderohet sipas Nenit 147 pikës 3 të KPK-së, kur Vrasja kryhet në mënyrë *mizore* dhe viktimës i shkaktohet vdekja me më shumë vuajtje sesa që është e nevojshme për vdekje, pra në rastin në fjalë viktima "është bërë copë e grimë për së gjalli". Në një masë motivi do të mund të konsiderohej edhe sipas Nenit 147 pikës 4 deri në pikën 9 të KPK-së, kur gjithnjë nevojitet në mënyrë të veçantë "tërësia e motiveve të kryerësit lidhur me qëllimin për të rrezikuar jetën e dikujt tjetër, duke vepruar në mënyrë të egër dhe të dhunshme, duke kryer krime me motive racore, kombëtare apo fetare, duke vepruar me qëllim të përfitimit material apo duke përgatitur apo fshehur një veprë tjetër penale apo duke vepruar me motiv të hakmarrjes së paskrupullt apo për shkak të motiveve të tjera të ulëta. Në të gjitha këto raste, elementet e radhitura më sipër, duhet të përfshihen përmes kriterëve subjektive të veprës penale, që do të thotë me qëllim nga ana e kryerësit.

16. Megjithatë, situata e përshkruar në paragrafin e mësipërm nuk është e pasqyruar edhe në rastin në fjalë, ku Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar elementet e Vrasjes së rëndë sipas Nenit 147 pikës 3 në alternativën e saj të dytë (kryerje e veprës në mënyrë dinake) dhe pikës 11 (kryerje e dy a më shumë vrasjeve). Në të dyja rastet ligji nuk kushtëzon gjetjen e motivit.

17. Në rastin në fjalë, Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se "...prokuroria pretendon se vrasjet janë kryer nga të pandehurit sepse [redacted] kishte përhapur

fjalë se [REDAKTUAR] ishte faktor për hedhjen e bombës në [REDAKTUAR] në Bulevardin [REDAKTUAR], i cili ka ndodhur më datën 23.9.2007 [...por se ...] prokuroria nuk ka dorëzuar prova të mjaftueshme lidhur me faktin se të pandehurit në të vërtetë janë informuar lidhur me këtë sjellje të [REDAKTUAR] (faqet 29-30 në versionin në gjuhën angleze).

Përkundër kësaj, Gjykata e shkallës së parë me të drejtë thekson se "...mungesa e provave të plota lidhur me motivet për këtë krim nuk paraqet asnjë pengesë për konstatimin e përgjegjësisë penale të të pandehurve ..." (faqja 30 në versionin në gjuhën angleze).

Në këtë kuptim, duhet të përmendet se Gjykata e shkallës së parë ka gjetur argumente të tjera për ta mbështetur opinionin e saj lidhur me përgjegjësinë penale të [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Gjykata ka shtjelluar argumentet e veta, në veçanti në faqen 31 të Aktgjykimit të kundërshtuar në versionin në gjuhën angleze.

2. Kushtëzimi i përmendjes së elementeve objektive dhe subjektive të veprës penale në dispozitiv:

18. Më serioz duket shqetësimi i mbrojtjes dhe i prokurorisë lidhur me atë se dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar nuk iu referohet askund elementeve objektive dhe subjektive të përcaktuara me Nenin 147 të KPK-së.

19. Sa i përket kushteve objektive të përcaktuara nga Neni 147 pikas 3 dhe 11 e KPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës është e kënaqur me përshkrimin e situatës dhe të veprimeve të të akuzuarit ashtu siç janë dhënë në dispozitiv në pikat a. dhe b. të cilat janë të mjaftueshme për përshkrimin e kriterëve objektive të Vrasjes së rëndë, në përputhje me ligjin, përderisa në shikim të parë dikush mund të bëjë vërejtje se mungon referimi i qartë në kriteret subjektive.

20. Megjithatë, Gjykata Supreme konstaton gjithashtu në këtë aspekt se dispozitivi së paku plotëson kushtet minimale lidhur me kriteret subjektive të parapara nga Neni 147 i KPK-së, pasi që pika a. thekson se të akuzuarit "...kishin vrarë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në mënyrë dinake në urën e [REDAKTUAR]" dhe se ata ia kishin "...zënë pritën veturës Golf 2 me tabela regjistrimi [REDAKTUAR] në të cilën ishin duke udhëtuar së bashku [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] (së bashku me [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR])...". Pika b. e dispozitivit të kundërshtuar thekson se "...ata kishin tentuar të vrisnin ... [dhe] ...t'ia zinin pritën veturës...". Në të dyja këto kontekste të dhëna formulimet e përdorura nga Gjykata e shkallës së parë së paku bëjnë të ditur se janë plotësuar kushtet subjektive të kryerjes së qëllimshme të krimit.

II. MOSPËRPUTHJA E POHUAR NË MES TË DISPOZITIVIT DHE ARSYETIMIT TË AKTGJYKIMIT TË KUNDËRSHTUAR

21. Gjykata Supreme konstaton se dispozitivi mbështetet plotësisht me gjetjet faktike dhe me vlerësimin e provave ashtu siç është dhënë në arsyetimin e Aktgjykimit të kundërshtuar.

1. Në këtë aspekt, u bëhet një referim i përgjithshëm gjetjeve të përgjithshme të Gjykatës së shkallës së parë ashtu siç janë theksuar në mënyrë të veçantë në faqet 7 - 29 të Aktgjykimit (në versionin në gjuhën angleze) si dhe vlerësimit të deklaratave të dëshmitarëve dhe të provave fizike një nga një ashtu siç është bërë në 10 - 24 të Aktgjykimit (në versionin në gjuhën angleze). Në veçanti, deklaratat e dëshmitarit [REDACTED] janë analizuar në hollësi dhe janë krahasuar me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, në mënyrë specifike të dëshmitarëve [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], and [REDACTED] as well as [REDACTED] në faqen 21 të Aktgjykimit (në versionin në gjuhën angleze).

2. Edhe pse një gjë e tillë nuk kundërshtohet në mënyrë të dukshme nga ana e mbrojtjes, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se është e nevojshme t'i referohet një aspekti të vendimit mbi dënimin, siç është shprehur në dispozitivin dhe në arsyetimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, pasi që ekziston posaçërisht fakti që sipas pikës 1.a. të dispozitivit të Aktgjykimit të shkallës së parë thuhet se "[REDACTED] dhe [REDACTED] janë dënuar me një dënim afatgjatë të burgimit prej gjithsej tridhjetë e tre (33) vjetësh lidhur me veprën penale të përshkruar në pikën a. [...]".

Lidhur me faktin se ekziston një mospërputhje e qartë lidhur me kohëzgjatjen e dënimit me burgim të shqiptuar për pikën a. të Aktgjykimit të kundërshtuar në mes të versionit të tij të zgjeruar (tridhjetë vjet) dhe pasqyrimin të tij si një numër prej 33 vjetësh, Gjykata Supreme konstaton se nuk mund të gjendet asnjë mospërputhje në mes të dispozitivit dhe arsyetimit apo brenda për brenda dispozitivit. Duke e lexuar dispozitivin si të tillë apo edhe Aktgjykimin si një dokument të plotë dhe në veçanti arsyetimin lidhur me dënimin në faqet 35 dhe 36 të Aktgjykimit (në versionin në gjuhën angleze), na bëhet shumë e qartë dhe pa asnjë dyshim se dënimi prej tridhjetë e tre (33) vjetësh burgim i është shqiptuar secilit të pandehur veç e veç. Kjo gjë del e qartë edhe gjatë leximit të vendimit mbi shqiptimin e dënimit unik, ku po ashtu dënimi është i përcaktuar në tridhjetë e tre (33) vjet. Kjo gjë pa dyshim se është në përputhje me Nenin 71 paragrafin 2 pikën 1 të KPK-së, i cili lidhur me rastin në fjalë ku kemi të bëjmë me vepra penale të bashkuara përcakton që "në qoftë se gjykata ka shqiptuar dënim afatgjatë me burgim për njërën nga veprat penale, ajo mjaftohet me shqiptimin e atij dënimi". Në këtë mënyrë, qartësohet rreshti në fjalë i dispozitivit të kundërshtuar të shkallës së parë i cili në të vërtetë përmban një gabim shtypi, i cili shumë lehtë mund të korrigjohet nga Gjykata e Qarkut, por nuk mund të çojë deri tek situata e cila përcaktohet me Nenin 403 paragrafin 1 pikën 12 të KPPK-së.

III. KUNDËRSHTITË E POHUARA BRENDË DISPOZITIVIT

22. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se nuk është gjetur asnjë shkelje e ligjit lidhur me kundërshtitë e pohuara apo me paqartësinë e shkaktuar nga koha e kryerjes së vrasjeve siç është përcaktuar në dispozitivin e Aktgjykimit të kundërshtuar në pikat a. dhe b.

1. Koha e kryerjes së krimit:

23. Edhe pse periudha kohore "[...] në mes të datave 27 dhe 28 shtator 2007 [...] në mes të orës 00.10 dhe 00.15 të natës" siç është thënë në dispozitivin e kundërshtuar e

cila gjë duket se bie në kundërshtim me veten, kjo dobësi nuk shpie në nevojën për anulimin e Aktgjykimit të kundërshtuar për shkak të shkeljes esenciale të procedurës penale, pasi që Aktgjykimi në tërësinë e vet është i qartë dhe nuk shkakton huti në këtë aspekt.

Nga arsyetimi i Aktgjykimit të kundërshtuar, lidhur me "vendndodhjen e [redacted] dhe të [redacted] menjëherë para dhe pas vrasjes", në faqen 26 të Aktgjykimit (në versionin në gjuhën angleze), qartësohet se Gjykata e shkallës së parë ka konsideruar një gjë të tillë si "fakt të pakontestuar se natën e vrasjes, para se të ndodhë vrasja, [redacted] dhe [redacted] kanë qenë në restorantin "[redacted]" ku po ashtu kanë qenë edhe viktimat" dhe se "[redacted] gjatë marrjes në pyetje ka pranuar se ka dalë nga restoranti "[redacted]" para mesnatës". Për më tepër, bazuar në dëshminë e [redacted] Gjykata konstatoi se viktimat e ndjera nga familja [redacted] "kanë arritur në restorant "[redacted] njëzet minuta pas tij ([redacted]) dhe kanë dal nga restorant "[redacted] rreth orës 23.40". Bazuar në të gjitha këto detaje dhe llogaritjen e kohës që nevojitet për të udhëtuar nga restoranti në urën e [redacted] është kryer krimi, gjykata e shkallës së parë pastaj ka përcaktuar pastaj ka përcaktuar kohën e supozuar të ngjarjeve nga faza e përgatitjes së menjëhershme deri në kryerjen e vrasjeve / vrasjeve në tentativë, gjë që kjo e fundit është përpunuar tërësisht në kontekstin e "[pasaktësia e alibisë të ofruar nga [redacted]" (f. 27-28 të versionit në gjuhën angleze). Gjykata e shkallës së parë në veçanti ka konstatuar se [redacted] dhe [redacted] kanë dal nga restorant [redacted] më 27 shtator 2007 në orën 23.40 dhe se në mes të 0.16 dhe 0.21 më 28 shtator 2007 ata janë ndaluar dhe kontrolluar nga një patrullë e policisë. Në mes të kësaj, vrasjet/vrasjet në tentativë janë kryer në [redacted]

Prandaj Gjykata Supreme konstaton se - megjithëse formulimi i përdorur në dispozitiv ka mundur të mos jetë më fatlumi - kjo nuk e bën dispozitivin kontradiktore në brendinë e tij, por me sa duket është shfrytëzuar për shkak të paqartësisë në lidhje me kohën e saktë të kryerjes së krimeve, e cila mund të përkufizohet vetëm përafërsisht duke iu referuar deklaratave të ndryshme të dëshmitarëve.

2. Përshkrimi i gjendjes faktike nën pikat a. dhe b. të dispozitivit:

24. Përmendja e "...së paku 40 gëzhoja të AK 47, kal. 7, 62 [që janë] shkrepur kundër veturës e cila përdorej nga viktimat ..." vetëm nën pikën b. por jo nën pikën a. të dispozitivit nuk mund të çoj në përfundimin se gjendja e përshkruar nën pikën a. është e ndryshme nga ajo e përshkruar nën pikën b. të dispozitivit. Gjithashtu pika a. qartë përcakton se "...në kohën përkatëse në mes të 00.00-00.15 të natës në mes të 27 dhe 28 shtator 2001 [...] të pandehurit i kanë vënë pritë makinës Golf 2 me targa 469 KS 117 në të cilin [redacted] dhe [redacted] (së bashku me [redacted] dhe [redacted] ishin duke udhëtuar në drejtim të fshatit [redacted] Prandaj, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar qartëson përtej dyshimeve serioze se të pesë viktimat e familjes [redacted] ishin duke udhëtuar së bashku në të njëjtën veturë në të njëjtën kohë dhe vend, kur u është vënë prita dhe në drejtim të tyre është shkrepur armë automatike.

IV. MOSPRANUESHMËRIA E PRETENDUAR E DEKLARATAVE TË
[REDAKTUAR] TË DATËS 02 SHKURT 2008 DHE 04 MARS 2009

25. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se çështjet e avokatit mbrojtës të [REDAKTUAR] të ngritura në kontekstin e dhënë janë të pa merita.

Neni 156 Paragrafi 2 të KPPK, që është i zbatueshëm në lëndën në fjalë, thotë me sa vijon:

(2) Deklarimi i dëshmitarit i dhënë në polici ose para prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur të pandehurit ose mbrojtësit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se deklaratat përkatëse të dëshmitarit Ramiz Tusha të dhëna në Polici më 2 shkurt 2008 dhe para Prokurorit më 4 mars 2009 në të vërtetë janë dhënë pa praninë e njërit nga të pandehurit apo avokatëve të tyre mbrojtës. Prandaj mos të mbetet pa thënë se ata nuk kanë pasur një shans për të kundërshtuar këto deklaratat në kohën kur ato ishin dhënë.

Megjithatë, edhe i pandehuri [REDAKTUAR] e po ashtu edhe avokati i tij mbrojtës [REDAKTUAR] (si edhe të pandehurit e tjerë dhe avokatët e tyre mbrojtës përkatës) kanë qenë të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë dhe në veçanti gjatë seancës më 17 qershor 2010, ku – në mes tjerash – dëshmitari [REDAKTUAR] ishte marrë në pyetje gjëresisht dhe ku është ballafaquar me të gjitha deklaratat e tij të dhëna gjatë procedurës penale deri në atë pikë. Prandaj, të pandehurit si edhe avokatët e tyre mbrojtës kanë pasur mundësinë të kundërshtojnë të gjitha deklaratat e dëshmitarëve sikurse kërkohet nga Neni 156 Paragrafi 2 i KPPK.

V. MANGËSITË E PRETENDUARA TË ARSYETIMIT NË LIDHJE ME
LIRIMIN E NYSRET CENA SIKURSE PËRCAKTOHET NË
DISPOZITIVË

26. Gjykata Supreme konstaton se nuk mund të vërtetohet mospërputhje midis pjesës të kundërshtuar të dispozitivit dhe pjesës përkatëse të arsyetimit.

Gjykata e shkallës së parë në veçanti ka vlerësuar deklaratat e [REDAKTUAR] dhe në mënyrë specifike atë të dhënë Prokurorit më 04 mars 2009 dhe ka arritur në mendimin se ka bazë të rëndësishme të kuptoj deklarimin e tij në mënyrën që ai nuk e ka njohur sigurt [REDAKTUAR] si vozitës i makinës që kinse ishte e përfshirë në pritë. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se "...nga deklaratat e [REDAKTUAR] është e qartë [...] se ai nuk e ka njohur [REDAKTUAR] para gjuajtjes dhe se kurrë nuk e ka parë makinën e tij. Në mënyrë specifike, për këtë arsye bëri familja [REDAKTUAR], në ditët pas gjuajtjes, është dashur ta dërgojnë atë përreth fshatrave me qëllim të shihet nëse ai mund të njohë një veturë të ngjashme me atë që ai e kishte parë në urë. Kjo e bën atë të qartë se interpretimi i mundshëm i vetëm i fjalisë së [REDAKTUAR] "një veturë e tillë është vozitur nga [REDAKTUAR]" është 'një lloj i tillë i veturës' ishte ngarë nga [REDAKTUAR]. Me fjalë të tjera, pasi ka filluar të dijë, (në ditët pas vrasjes) se [REDAKTUAR] kishte në pronësi një veturë të ngjashme, ai ishte në pozitë t'i vërtetonte Prokurorit se [REDAKTUAR] ka vozitur një veturë të tillë. [REDAKTUAR] në të njëjtën kohë ishte shumë i qartë në vërtetimin se ai nuk

e ka njohur [REDACTED] në veturë” (f.33 e aktgjykimit të kundërshtuar të versionit në gjuhën angleze).

Bazuar në këtë vlerësim Gjykata e Qarkut ka arritur në përfundimin logjik se ka nuk ka prova të cilat duhet të interpretohen në debi të të akuzuarit [REDACTED]

B. Shkelje e pretenduar e Ligjit Penal

27. Avokatët mbrojtës [REDACTED] dhe [REDACTED] për të pandehurin [REDACTED] Av. [REDACTED] për të pandehurin [REDACTED] (kufizuar në të fundit i shpallur tërësisht fajtor) si edhe PSRK ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë për shkelje të pretenduar të Ligjit Penal. Në veçanti, aktgjykimi do të ishte i pamjaftueshëm në lidhje me kryerjen e pretenduar të vrasjeve të rënda (në tentativë) në ‘mënyrë tinëzare’ sikurse kërkohet nga Neni as 174 të KPK. Pra, do të shkelej Neni 404 Paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 të KPPK.

28. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i kundërshtuar i plotëson të gjitha kushtet e Nenit 147 pikat 3 dhe 11 të KPK, për të cilat i akuzuari [REDACTED] dhe [REDACTED] janë shpallur fajtor.

29. Neni 147 pikat 3 dhe 11 të KPK thotë me sa vijon:

Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili:: ...

3) *Privon nga jeta personin tjetër në mënyrë dinake;;*

...

11) *Me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenet 148 dhe 150 të këtij Kodi ...*

30. Edhe pse aktgjykimi i kundërshtuar nëpërmjet shumicës së gjithsej 37 faqeve të tij ka një fokus të qartë në çështjet provuese dhe vlerësimin e provave, kjo e bën referencë të qartë dhe të padiskutueshme në kushtet objektive dhe subjektive të Nenit 147 pikat 3 dhe 11 të KPK-së, të cilat janë klasifikuar atje si *actus reus* dhe *mens rea* (f.31-32 të versionit në gjuhën angleze).

Në lidhje me kushtet e Nenit 147 pika 3 e KPK për kryerjen e vrasjes në mënyrë dinake aktgjykimi i shkallës së parë përcakton në veçanti se “...sjellja e të pandehurve para gjuajtjes ishte tipike një pritë e dhunshme (ata ishin transportuar dhe dërguar në vendin e ngjarjes në natë shumë të qetë, të armatosur me armë të gjata, vetëm dhjetë minuta para gjuajtjes, në një vend të izoluar)” (f.31 e versionit në gjuhën angleze) dhe se prandaj “...vrasja ishte bërë në një mënyrë dinake, duke konsideruar faktin se të pandehurit i kanë vënë pritë veturës së viktimave natën, nga ana e rrugës, duke i befasuar viktimat të cilët nuk kanë mundur madje as të përpiqen të organizojnë një reagim”.

Në lidhje me kushtet e Nenit 147 pika 11 të KPK për kryerjen me dashje të dy apo më shumë vrasjeve, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se “...po ashtu edhe rrethana e Nenit 147 n.11 është e pranishme, në atë se tre persona u vranë në të njëjtën kohë nga veprimet e të pandehurve, të cilët që të dy në mënyrë të barabartë u pajtuan me kryerjen

e veprës penale (pra duke integruar edhe dispozitën e Nenit 23 të KPPK) ' (f.32 e versionit në gjuhën angleze).

Në lidhje me kushtet subjektive të Nenit 147 të KPPK, në aktgjykimin e kundërshtuar të karakterizuar si *mens rea*, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se "...qëllimi i kryerësit për një veprë penale, në mungesë pranimi të provës gojore, duhet të nxirret nga objektiviteti i veprimeve.

Në lëndën në fjalë nuk mund të ketë dyshime, në marrjen parasysht të:

- *mënyra e kryerjes së krimit (të shtënat me armë automatike) nuk mund të shpjegohet ndryshe përveç duke supozuar ekzistencën e vullneti për të vrarë)*
- *organizimin e pritës, me përfshirjen e disa personave, nënkupton domosdoshmërisht vullnetin e vetëdijshëm për të kryer veprë penale.*

Me fjalë të tjera, kolegji konsideron se jo vetëm që ishte vullneti për të vrarë, por edhe paramendim për ta bërë atë' (f.32 e versionit në gjuhën angleze).

31. Gjykata Supreme e Kosovës është e kënaqur që shkalla e parë ka vlerësuar siç duhet të gjitha kushtet e Nenit 147 pikat 3 dhe 11 të KPK-së, si ato objektive po ashtu edhe ato subjektive.

32. 1. **Sa i përket Nenit 147 pika 3 të KPK**, të tre viktimat të cilët kanë gjetur vdekjen, u është vënë prita dhe janë marrë në befasi. Në këtë kontekst, mbrojtja gjatë seancës së apelit ka ngritur çështjen, nëse mënyra e kryerjes duhet kualifikuar si 'dinake' në kuptim të Nenit 147 pika 3 të KPK dhe nëse kjo e fundit ka të njëjtën kuptim sikurse shprehja 'mënyrë tinëzare' sikurse parashikohet nga Neni 47 Paragrafi 2 të Kodit Penal të vjetër të Republikës së Serbisë (KP RSFJ).

33. Komentimet për Ligjin e vjetër përcaktojnë se "[Komponenti objektiv i 'tinëzare' është mënyra e kryerjes së vrasjes, e fshehtë dhe sekrete (nga një pritë; derisa viktimat është në gjumë, nga mbrapa, me helm pa ngjyrë, erë apo shije; nga lëshimi i mikrobeve infektuese etj.). Përveç veprimit fizik, mund të ketë veprim kimike dhe biologjike mbi viktimën. Ana subjektive e vrasjes tinëzare karakterizohet me shfrytëzim qëllim keq, të pandershëm dhe dinak të besimit të fituar të viktimave ose nga pafuqia e tyre apo çiltërsia. Prandaj, ekzistenca e 'tinëz' në kryerjen e vrasjes nuk mund të bazohet vetëm në rrethana objektive, dhe prandaj një sërë aktgjykimesh pasqyrojnë se një vrasje nga prita ose kur viktimat është në gjumë, me helm apo nga mbrapa, nuk paraqet bazë të mjaftueshme për ta konsideruar vrasjen e kryer si tinëzare. Është ende e domosdoshme për të vërtetuar se kryerësi në mënyrë dinake ose mizore ka keqpërdorur besimin e viktimës, në bazë të një marrëdhënie të gjatë ose të një cilësie të caktuar të autorit të krimit (p.sh. një mjek, polic dhe të tjerë)" (Srentic, Nikola; Stajic, Aleksandar; Kraus. Bozidar; Lazarevic, Ljubisa; Djordjevic, Miroslav në: *Komentimi i Ligjeve Penale të RS të Serbisë, KSA e Kosovës dhe KSA e Vojvodinës; komentimi i tretë 1981; Savremena Administracija; Beograd*).

Nga ky koment mund të kuptohet se termi 'dinak' tashmë është përdorur në lidhje me anën subjektive të 'tinëzare', siç parashikohet në Ligjin e vjetër. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës e kupton se 'dinakëri' siç përmendet në nenin 147 pika 3 të KPK është identike me 'tinëzari' sikurse është e njohur me Ligjin e vjetër.

34. Në lëndën në fjalë, një mënyrë e sulmit sikurse është përshkruar më sipër (duke vënë në pritë dhe duke kapur viktimat në befasi), është dinake nga përcaktimi dhe të

pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] kanë qenë në dijeni për këtë, duke i kontribuar në mënyrë aktive metodës sesi krimet janë kryer.

35. 2. Në lidhje me Nenin 147 pika 11 të KPK, të mos mbetet pa thënë se vrasja e tre personave të cilët kanë udhëtuar në të njëjtën veturë me përdorimin e dy pushkëve automatike AK-47 dhe shkretpja e breshërisë e së paku 40 plumbave kundër tyre i plotëson po ashtu të gjitha kriteret objektive të Nenit 147 pika 11 të KPK. Në lidhje me elementet subjektive të veprës penale të Vrasje e Rëndë në lëndën në fjalë që kërkon dashjen sikurse përcaktohet me Nenin 15 të KPK, është me rëndësi të përmendet se tanimë ligji i vjetër identifikoi konstruksionin sikurse ai i shpjeguar me Nenin 147 pika 11 e KPK. Në veçanti Neni 47 i Kodit Penal të Serbisë është komentuar mbi çështjen, duke nënvizuar se *"kjo veprë penale ekziston vetëm kur të paktën dy ose më shumë persona kanë qenë të privuar nga jeta. Nëse vetëm një person ka qenë i privuar nga jeta dhe ka pasur një përpjekje për të privuar nga jeta një person tjetër, kjo nuk përbën vrasje në tentativë nga pika 6) nëse kryerësi ka paramenduar vrasjen e disa personave; e nëse është e kundërta, kjo konsiderohet një marrëveshje reale në mes të një vrasje të kryer dhe në tentativë"*. (Srzentic, Nikola; Ljubisa Lazarevic; Komentimi i Kodit Penal të Serbisë 1995; Botimi i 5të në: "Savremena Administracija"; Beograd; (Neni 47 i KPS; pika 9)). Në këtë sfond, për lëndën në fjalë mund të nxirret se dashja sipas Nenit 147 pika 11 të KPK-së kërkon dashje direkte siç përcaktohet në Nenin 15 paragrafi 1 dhe 2 të KPK, kështu që vrasjet e shumëfishta kryhen qëllimisht, kur kryerësi është në dijeni për veprimet e tij ose të saj dhe dëshiron kryerjen e tyre. Përveç asaj që tashmë shkalla e parë e ka vënë në dukje anën subjektive të krimin, duhet përmendur se gjuajtja e një breshërie plumbash (në lëndën në fjalë të paktën 40 gëzhoja) nga dy pushkë automatike në një automjet me pesë udhëtarë përmban një mundësi të lartë për të gjithë këta të fundit që janë vrasë. Duke pasur këtë në mendje, po ashtu edhe qëllimin dhe paramendimin e kryerësve këtë opsion duhet përfshirë si më të mundshmin.

C. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

36. Të dy avokatët mbrojtës të [REDACTED], Av. [REDACTED] dhe Av. [REDACTED] [REDACTED] si edhe avokati mbrojtës i [REDACTED] Av. [REDACTED] i pandehuri [REDACTED] [REDACTED] ky i fundit gjatë seancës së apelit i përfaqësuar përmes avokatit të tij mbrojtës [REDACTED] dhe PSRK ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të pretenduar të gjendjes faktike sipas Nenit 402 Paragrafi 1 pika 3 të KPPK. Avokati i [REDACTED] ka theksuar se vlerësimi i deklaratave të ndryshme në veçanti të dëshmitarit [REDACTED] do të ishte i pamjaftueshëm sepse është zgjedhor dhe i njëanshëm në dëm të të pandehurit. Prandaj asnjëherë nuk është vërtetuar siç duhet, - kush - i ka kryer vrasjet - e pa kontestuara. PSRK, në të kundërtën, ka kritikuar se gjykata e shkallës së parë nuk i besoj plotësisht deklaratës së [REDACTED] sikurse është dhënë më 04 mars 2009. Për shkak të këtij vendimi, i pandehuri [REDACTED] është shfajësuar gabimisht. Përfundimisht, i pandehuri [REDACTED] ka theksuar se me sa ai ka kuptuar asnjëherë nuk është provuar se ai ka pasur ndonjëherë në posedim një AK-47 sikurse u deklarua nga dëshmitarët [REDACTED] dhe [REDACTED]. Për të gjitha këto arsye aktgjykimi i kundërshtuar do të shkelte edhe Nenin 405 të KPPK.

I. VLERËSIMI ZGJEDHOR DHE I PAMJAFTUESHËM I PRETENDUAR I DEKLARATAVE TË DËSHMITARËVE, VEÇANËRISHT NË LIDHJE ME [REDAKTUAR]

37. Gjykata Supreme konstaton se nuk mund të vërtetohet shkelja e ligjit në lidhje me vlerësimin e deklaratave të dëshmitarit nga gjykata e shkallës së parë.

1. Vlerësim selektiv i provës në dëm të [REDAKTUAR]:

38. Në veçanti, duhet të theksohet se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në mënyrë shumë të kujdesshme të gjitha provat e paraqitura në dëm e edhe në dobi të të pandehurve. Referimi është bërë në listën e dëshmitarëve të marrë në pyetje sikurse është paraqitur në historinë e procedurës në f. 7 të këtij aktgjykimi. Gjykata e shkallës së parë jo vetëm që i ka analizuar në të gjitha detajet deklaratat e ndryshme të dëshmitarit-kryesor [REDAKTUAR], por ka renditura të gjitha deklaratat e tij të ndryshme, ka shpjeguar pozitën e të pandehurit sipas këtyre deklaratave, ka shtjelluara për pjesët e tyre të kontestuara dhe jo të kontestuara si edhe mbi kredibilitetin dhe besueshmërinë e vet dëshmitarit por gjithashtu ka shikuar në arsyet e mundshme për akuzime të rrejshme kundër të pandehurve nga perceptimi i [REDAKTUAR], kërcënimet e familjeve të të pandehurve kundër tij dhe i ka vënë deklaratat e [REDAKTUAR] në marrëdhënie me deklaratat konfirmuese të dëshmitarit, në veçanti të [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si edhe [REDAKTUAR] (f.10-23 të versionit në gjuhën angleze). Përfundimisht, gjykata e shkallës së parë po ashtu ka vënë në pah se dëshmitarë të caktuar të përfaqësuar nga mbrojtja janë konsideruar të parëndësishëm dhe prandaj nuk janë pranuar (f.6 e versionit në gjuhën angleze).

Gjykata Supreme e Kosovës natyrisht e kupton se vlerësimi i deklaratave të [REDAKTUAR] në veçanti nga gjykata e shkallës së parë është selektiv sa i përket asaj se gjykata disa pjesë të caktuara të këtyre deklaratave i ka konstatuar të besueshme, ndërsa kjo nuk është konsideruar të ketë ndodhur në pjesët e tjera. Megjithatë, referenca është bërë për analizat fundamentale të këtyre deklaratave në aktgjykimin e kundërshtuar dhe arsyet e vlerësimit të dhëna atje.

39. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në fakt as nuk është në kompetencë të kolegjit të apelit e as e mundshme të zëvendësohen gjetjet e gjykatës së shkallës së parë me të vetat, posaçërisht jo pa marrë përsëri të gjitha provat. Në lëndën [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05 të datës 25 janar 2008, faqe 20), Gjykata Supreme e Kosovës në këtë kontekst ka vënë në pah se "procedura ankimore në KPPPK mbështetet në parimet që trupi gjykues i dëgjon, vlerëson dhe peshon provat në gjykim [...]. Prandaj, gjykata e apelit duhet t'i jap trupit gjykues hapësirë veprimi për gjetjet e saj faktike. Nuk duhet t'i trazon gjetjet e trupit gjykues për t'i zëvendësuar me të vetat, përveç nëse provat në të cilat është mbështetur trupi gjykues nuk do të ishin pranuar nga asnjë gjykatë e arsyeshme e faktërit ku vlerësimi i saj ka qenë 'tërësisht i gabuar'".

Prandaj, si rregull, kjo gjykatë nuk do të elaboroj në mbledhjen e provave dhe në bazë të kësaj për detajet e gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë.

2. Besueshmëria e deklaratës së [REDAKTUAR] e datës 04 mars 2009:

40. Gjithashtu në lidhje me deklaratën e [REDAKTUAR] e dhënë para Prokurorit dhe e datës 04 mars 2009 referenca është bërë në atë çfarë është thënë më herët. Gjykata Supreme nuk do të anulohet vlerësimin e provave të kryera nga gjykata e shkallës së parë *përveç nëse provat në të cilat është mbështetur trupi gjykues nuk do të ishin pranuar nga asnjë gjykatë e arsyeshme e faktorit ku vlerësimi i saj ka qenë 'tërësisht i gabuar'.* Kjo nuk mund të vërtetohet në lëndën në fjalë.

II. VLERËSIM JO I DUHUR I PRETENDUAR I PROVAVE NË DËM TË TË PANDEHURIT [REDAKTUAR]

41. Sa i përket të akuzuarit [REDAKTUAR] ai ka theksuar se asnjëherë nuk është provuar se ai ka qenë në posedim të një pushke Kallashnikov AK 47 dhe se gjykata e shkallës së parë është gabuar kur u ka besuar dëshmitarëve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], referenca i është bërë përsëri gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë për çështjen siç është shkruar në f. 34 të versionit në gjuhën angleze.

Përsëri, Gjykata Supreme nuk do të zëvendësojë gjetjet e gjykatës së shkallës së parë me të vetat për shkak të faktit se vlerësimi i Gjykatës së Qarkut në asnjë pjesë nuk lë aspak përshtypjen e të qenit jo arsyeshëm.

III. PROVA TË REJA TË SUPOZUARA TË PROKURORIT PUBLIK QË DO TË ÇONIN NË NDRYSHIMIN E THELBIT DHE NË LIRIMIN E TË PANDEHURVE [REDAKTUAR] I DHE [REDAKTUAR]:

42. Së fundi, një fjalë duhet t'i kushtohet pyetjes nëse Prokurori Publik do të ketë prova të reja që do të paraqiten në gjykatë, që për pasojë do të çonte në një ndryshim të plotë të thelbit dhe në lirimin e të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] sikurse është propozuar nga avokati mbrojtës i [REDAKTUAR], Av. [REDAKTUAR] gjatë seancës së apelit më 11 tetor 2011.

43. Kjo në këtë pikë duhet të përmendet se as mbrojtja as Prokuroria nuk kanë paraqitur ndonjë provë të re. Kjo e fundit mund të pritej në mënyrë të veçantë nga mbrojtja, pasi që gjetja dhe paraqitja e argumenteve në favor të të pandehurve është detyra më eminente e tyre. Megjithatë, edhe pse sipas propozimit të avokatit mbrojtës Av. Mahmut Halimi në mënyrë të qartë është pyetur nga Kryetari i kolegjit në seancën e apelit nëse Prokurori dëshiron të paraqes prova të reja në gjykatë, po ashtu edhe Prokurori i ZPSRK Jusuf Mezini përfundimisht qartë e ka mohuar. Gjithashtu është me rëndësi të përmendet në kontekstin e dhënë se jo zyrtarisht i është komunikuar Kryetarit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, por pas seancës së apelit, se i pandehurit [REDAKTUAR] i cili deri më tani është mbrojtur tërësisht në qetësi, së bashku me të pandehurin [REDAKTUAR] ndërkohë (pas shpalljes së tyre fajtor për vrasjet) kanë deklaruar para Prokurorit se ka qenë i pandehuri i liruar [REDAKTUAR] së bashku me disa nga dëshmitarët e tjerë, që kanë shtënë në veturën e viktimave. Për më tepër, të nënshkruarit i është komunikuar se ZPSRK ka hapur një rast të ri për shkak të kësaj dhe

se – para se të filloj seanca e apelit – është paraqitur një aktakuzë e re tanimë, tani kundër [REDAKTUAR] dhe të tjerëve.

44. Pavarësisht se, edhe Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka dhunti aftësitë profetike dhe prandaj nuk mund të supozoj vetëm atë që njëra nga palët në gjykim mund të dëshiroj të paraqes, nëse kjo në fakt nuk është bërë përfundimisht, atëherë konsiderohet pothuajse e tepërt të përmendet se në rast të provave të reja të pretenduara, ri-hapja e procedurës kundër [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] sipas Neneve 438 deri në 447 të KPPK do të ishte mënyrë e duhur për të ri-hyr në procedurën e gjykatës kundër të pandehurve të tjerë, në veçanti atyre të cilët tanimë janë liruar në lëndën përkatëse. Kjo e fundit në veçanti vlen për ish bashkë të pandehurin [REDAKTUAR] nën parimin e *ne bis in idem*, që për Ligjin e Kosovës në fuqi është përcaktuar nga Neni 4 paragrafi 1 të KPPK.

D. Vendimi për dënimin

45. Avokati mbrojtës [REDAKTUAR] për të pandehurin [REDAKTUAR] dhe i pandehuri [REDAKTUAR] që të dy kanë kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë për shkak të vendimit për dënimin. Që të dy – secili nga ata si rezultat i linjës së tij përkatëse të argumentimit – kanë arritur në mendimin se rezultati i vetëm i mundshëm i gjykatës së shkallës së parë do të ishte lirimi i [REDAKTUAR] si edhe i [REDAKTUAR] nga të gjitha akuzat.

46. Vendimi për dënimin është i drejtë sa u përket të dyve, të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si edhe të akuzuarit [REDAKTUAR].

Sa i përket të akuzuarit [REDAKTUAR] mbrojtja ka theksuar se i akuzuari duhet të lirohet për shkak të faktit se pjesëmarrja e tij në kryerjen e Vrasje e Rëndë nuk është provuar.

Referenca është bërë në atë që u theksua më parë, nën pikën C (f.13-14 të këtij aktgjykimi). Pasi që gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të kujdesshëm të të gjitha provave në dispozicion ka ardhur në përfundim se [REDAKTUAR] së bashku me [REDAKTUAR] duhet të shpallen fajtor për krimet me të cilat janë akuzuar, janë dhënë baza të mjaftueshme për vërtetimin e dënimit. Pasi që dënimi si i tillë nuk u kundërshtua nga mbrojtja deri më tani, Gjykata Supreme është e kufizuar të deklaroj se formulimi i dënimit është në pajtueshmëri me ligjin dhe që edhe kohëzgjatja e tij konsiderohet e drejtë, duke pasur parasysh peshën e krimeve në fjalë.

47. Sa i përket të akuzuarit [REDAKTUAR] Gjykata Supreme konstaton se dënimi i propozuar është i balancuar sa i përket ashpërsisë së krimit për të cilin i akuzuari është shpallur fajtor.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe tërësisht ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në ashpërsinë e ndëshkimit dhe ka vlerësuar në mënyrë të drejtë këto rrethana, si në dëm ashtu edhe në dobi të të akuzuarit. Vendimi i gjykatës në këtë drejtim është i dyfishtë. Përderisa faktet se i akuzuari nuk ka ndonjë shënim të mëhershëm penal, intensiteti dhe kohëzgjatja e konfiskimit të armëve u konsiderua e një rëndësie jo të veçantë dhe duke pasur parasysh edhe qëndrimin

korrekt të të akuzuarit gjatë tërë procedurës penale, gjykata e shkallës së parë konsideroi të mjaftueshme një gjobë në vend të dënimit me burgim.

Kjo e fundit më pas u përcaktua me 5,000.00 euro, duke marrë parasysh rëndësinë e kontributit të të akuzuarit. Edhe pse gjykata e shkallës së parë nuk ka elaboruar në mënyrë të qartë metodën, me të cilën ata kanë llogaritur ndëshkimin prej 5,000.00 Euro, kjo e fundit del nga dënimi siç përcaktohet në dispozitiv, kur gjykata konstaton se në rast se gjoba nuk mund të merret me detyrim, të akuzuari do t'i zëvendësohet me një ditë burgim për çdo 15 euro të gjobës. Prandaj, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar vendimin e saj në të ardhura të përditshme të supozuara të të akuzuarve prej rreth 15,00 euro, e cila nuk konsiderohet joreale. Kështu, i akuzuari ishte gjobitur me 333,33 tarifa të të ardhurave ditore, që i korrespondon me përafërsisht një vit burgim.

Duke pasur parasysh peshën e krimeve të kryera me armë të transportuara nga i akuzuari, ky dënim konsiderohet i ekuilibruar. Prandaj, nuk shihet asnjë arsye për të ulur dënimin.

Për arsye paraprake Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv.

Anëtarët e kolegjit:

Charles Smith III.
Gjyqtar i EULEX-it

Martti Harsia
Gjyqtar i EULEX-it

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Kryetari i kolegjit:

Procesmbajtësi:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Holger Engelmann
Zyrtar Ligjor i EULEX-it

Këshillë juridike

Në pajtueshmëri me Nenin 430 Paragrafi 1 nën -paragrafi 1 dhe Neni 398 Paragrafi 1 i KPPK, kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë mund të paraqitet ankesë nëse gjykata e shkallës së dytë ka shqiptuar dënimin me burgim afatgjatë ose ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin është shqiptuar një dënim i tillë. Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas dorëzimit të kopjes së aktgjykimit përmes Gjykatës kompetente të Qarkut në Gjykatën Supreme të Kosovës.